



TV Vali
Lindita FAZLIU
Drejtoreshë
Gjilan

Ankesa Nr. 2017/51 KPM vs TV Vali
Ref:1708/794/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/51 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV Vali
("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është televizion regional me seli në Gjilan. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 12 mars 2010. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
3. KPM me datën 29 maj 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore.
4. KPM, bazuar në monitorimet që janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spotin politik të subjektit të certifikuar politik PAN të cilin e ka identifikuar si spot me pagesë, por jo duke e identifikuar se nga kush është paguar apo është sponsoruar ky spot.

Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka

transmetuar spote politike të cilat i ka identifikuar si spote me pagesë, por nuk ka treguar se nga kush janë të paguara apo të sponzoruar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin “përgjegjës për të”.

6. KPM duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073

Vendimi

7. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073.
8. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073.

E drejta për Ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë